

DITARI MUJOR

**SHTATOR
2025**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT,
KULTURËS DHE SPORTIT

FILLON NJË KAPITULL I RI: SHQIPËRIA 2030 – QENDËR EUROPIANE E KULTURËS, SPORTIT DHE MIKPRITJES



Me besimin e Kryeministrit Edi Rama dhe mbështetjen e Presidentit Bajram Begaj, u dekretua ministri i ri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit. Ky mandat vjen me një vizion të qartë për ta kthyer Shqipërinë 2030 në një qendër europiane ku kultura, sporti dhe mikpritja ndërthuren për të ndërtuar një identitet të fortë kombëtar dhe për ta pozicionuar vendin përtej rolit të tij si destinacion turistik. Në këtë rrugëtim, vlerësohet puna e 19 muajve në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, ku u ngritën struktura dhe u realizuan projekte që do të vijojnë me energji dhe sukses edhe në këtë mandat.

SPORTI SHQIPTAR NË ARENËN BOTËRORE – LARA COLTURI NË OLIMPIADËN MILANO-CORTINA 2026

Nënkampionja e botës në skitë alpine, Lara Colturi, u mirëprit si një shembull frymëzues për sportistët e rinj shqiptarë dhe për gjithë kombin.

Me përfaqësimin dinjitoz të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, ajo do të jetë një nga katër flamurmbajtësit kuqezë në Lojërat Olimpike Dimërore Milano-Cortina 2026.

Pjesëmarrja e saj historike ngre pritshmëritë për medalje olimpike dhe afirmon vendosmërinë e Qeverisë Shqiptare për ta bërë sportin një prioritet strategjik, duke ndërtuar një sistem që promovon talentin, barazinë e mundësive dhe përfaqësimin në nivelet më të larta ndërkombëtare.



SHQIPËRIA, PORTA E RE E INVESTIMEVE NË RAJON



Në Vjenë u zhvillua Forumi i Investimeve “Albania: A New Frontier”, me pjesëmarrjen e Kryeministrit Edi Rama, ku u prezantuan mundësi konkrete bashkëpunimi me Korporatën e Investimeve Shqiptare, AIDA-n, Raiffeisen Bank dhe kompani të tjera vendase e ndërkombëtare.

Nga një “xhevahir i fshehur”, Shqipëria është kthyer në një destinacion të njohur mesdhetar, me miliona vizitorë dhe ndikim të ndjeshëm në zhvillimin ekonomik.

Projektet e marianave të Durrësit dhe Vlorës, hyrja e brandeve dhe arkitektëve globalë, si dhe një klimë gjithnjë e më konkurruese për biznesin, po e kthejnë Shqipërinë në një destinacion katërstinë me standarde ndërkombëtare dhe vizion të qartë drejt integritimit europian.

TURIZMI NË FOKUS – PRIORITETE DHE VIZION PËR NJË DESTINACION GJITHËVJETOR



Në takimin e parë me ekipin e Turizmit u përcaktuan prioritetet kryesore të sektorit:

- Forcimi i bashkëpunimit me partnerët vendas e ndërkombëtarë
- Nxitja e investimeve cilësore
- Promovimi i Shqipërisë si një destinacion unik dhe të qëndrueshëm

Synimi është që turizmi të bëhet shtylla e zhvillimit ekonomik, kulturor dhe social, duke e kthyer Shqipërinë në një model të suksesshëm rajonal.